

Shpresojmë që ky email të ju gjej mirë!

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) po kryen një analizë gjinore: Zbutja e ndryshimeve klimatike përmes përmirësimit të transportit. Ky hulumtim po kryhet në kuadër të Rrjetit të Monitorimit të Buxhetimit Gjinor, i mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida).

Bazuar në [Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike](#), ne si RrGK ju lusim të na dërgoni përgjigjet për pyetjet e mëposhtme:

1. Të dhëna mbi incidencën ose prevalencën e kushteve shëndetësore të ndërlidhura me ndryshimet klimatike, të shkaktuara nga faktorë si ndotja, temperaturat e larta, përmbytjet, etj.; lloji i ndikimit në shëndet, i ndarë sipas gjinisë (burrë, grua) dhe moshës, komunës dhe përkatësisë etnike, nëse është në dispozicion, për rajonin ose popullsinë specifike.
2. Të dhëna mbi efektivitetin e ndërhyrjeve aktuale në shëndetësinë publike, të cilat synojnë të zbusin ndikimet e ndryshimeve klimatike. Konkretisht, cilat politika, plane veprimi ose strategji janë zbatuar, dhe cilat janë rezultatet e tyre në përmirësimin e shëndetit publik?
3. A keni ndonjë parashikim se si pritet që ndryshimet klimatike të ndikojnë në shëndetin publik në pesë dhe 10 vitet e ardhshme? A përfshijnë këto se si një ndryshim i tillë do të ndikojë te gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme, sipas moshës, përkatësisë etnike, komunës ose faktorëve të tjerë?

Nëse nuk i keni këto të dhëna në dispozicion, ju lutemi na njoftoni. Ne gjithashtu do të mirëprisnim një takim për të diskutuar me ju.

Faleminderit për mbështetjen tuaj me këtë hulumtim.

Sinqerisht,

Rrjeti i Grave të Kosovës

Rrjeti i Grave të Kosovës - RrGK

Mreža Žena Kosova - MŽK

Kosova Women's Network - KWN

Rr. Kadri Gjata, Kati I, Nr. 8

10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

+383 38 245 8501kshpk

|
Wed 3/12/2025 1:04 PM

Të nderuar, lidhur me kërkesën tuaj:

Të dhënat mbi incidencën ose prevalencën e sëmundjeve infektive janë të publikuara në web faqen e Institutit Kombëtar si: "Buletini i Sëmundjeve infektive", ndërsa raportet mujore dhe vjetore për sëmundjet jo-ngjitëse, i gjeni në publikimin: 'Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës dhe sistemit shëndetësor për vitin 2022'. <https://niph-rks.org/>

Ne e kemi realizuar hulumtimin për vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike në shëndetin e popullatës për periudhën 2018-2022 . Hulumtimi në njerën anë vlerëson ndikimin e ndryshimeve klimatike në shëndet dhe në anën tjetër infrastrukturën dhe gadishmërinë e institucioneve shëndetësore për tu përballur me situatat ekstreme si: temperaturat e larta, vërshimet dhe thatësitë .

Po ju përcjelli linkun ku mund të gjeni pjesë të publikuara të këtij hulumtimi:

1(PDF) MAPPING THE CURRENT AND FUTURE CLIMATE EXTREMES AND HEALTH THREATS TO VULNERABLE POPULATIONS IN KOSOVO

Me respekt,

Era Pireva

Zyrtare për Informim

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës